



RENOFIX 360

LLAÇ STRUKTURAL PËR MBËSHTJELLJE
TË SIPËRFAQEVE TË MUREVE TË BRENDSHËM

Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik!

HAPËSIRAT E PËRDORIMIT:

Llaç i bardhë struktural (fisnik) për mbështjellje (abrib) CR-CS II-Ë2 sipas EN 998-1. Përdoret për mure të brendshëm dhe sipërfaqet e tavaneve, mbi llaçe themelore nga çimento, gipsi dhe gëlqerja si dhe mbi pllaka ndërtimi paraprakisht të përpunuara (pllaka gipskartoni).

PËRMBAJTJA:

- Gëlqere
- Çimento e bardhë
- Rërë të bardhë mermeri të klasuar me granulacion të ndryshëm

VEÇORITË:

- Ngjyrë të bardhë me shkëlqim
- Përpunim të mirë
- Ekologjikisht i preferuar

PËRGATITJA E BAZËS:

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastruar nga pluhuri dhe mbeturinat. Llaçet themelore të gipsit apo çimentos duhet të jenë të thatë dhe të pastër. Gjithashtu e tërë sipërfaqja apo pllakat e gipskartonit duhet paraprakisht të rrafshohen mirë me Renofix 18 ose me Renofix 15 i bardhë. Renofix 360 mund të vendoset vetëm pasi materialet rrafshuese të lartpërmendura të jenë thatë plotësisht.

PËRGATITJA E LLAÇIT:

Një thes Renofix 360 zbrazet në 7.5-8 litra ujë të pastër dhe përzihet me mikser për 2-3 minuta deri sa të fitohet masë homogjene. Gjatë kohës së shfrytëzimit të materialit të përzier, i njëjti duhet përzier kohë pas kohe me qëllim që të mos ndodh shtresimi (fundosja) e granulave.

PËRPUNIMI DHE K U S H T E T E PËRPUNIMIT:

Llaçi vendoset me rrafshues metali (gletkele). Strukturimi i llaçit bëhet me fërkuese të përshtatshme për filcim (nga stiropori dhe plastika). Trashësia e shtresës së suvatimit varet nga madhësia e thërmisë (granulës). **Nuk lejohet përdorimi në temperaturë nën +5°C.** Nuk lejohet përzjerja me materiale tjera.



VËRREJTJE:

Përmban gëlqere të shuar. Irriton sytë dhe lëkurën. Në raste të tilla, lëkura të lahet me ujë të pastër, ndërsa për sytë kërkoni ndihmën e mjekut.

PAKETIMI:

Renofix 360 paktohet dhe shpërndahet në thasë letre nga 30 kg. që janë të mbrojtur nga lagështi

DEPONIMI:

Të deponohet në hapësira të thata, mbi paleta të drurit. Afati i deponimit është 6 muaj.


Të dhëna teknike:	
Numri i prodhimit	5319990620217
Shifra e prodhimit:	1360,5 1361 1361,5 1362 1363
Thasë në paletë:	36
Sasia e nevojshme e ujit:	7,5 - 8 l./Thes

RENOFIX 360

Granulacioni:	0,5 mm	1 mm	1,5 mm	1,5 mm	2 mm	2 mm	3 mm
Struktura e materialit dekorues:		R	R	V	R	V	R
Ngjyra	E BARDHË						
	18,5 - 16,5 m ² /EH	15 - 14,5 m ² /EH	13,6 - 11,5 m ² /EH	13,6 - 11,5 m ² /EH	10 - 9,3 m ² /EH	10 - 9,3 m ² /EH	6,6 - 7,2 m ² /EH
Harxhimi:	1,6 - 1,8 kg/m ²	2 - 2,1 kg/m ²	2,2 - 2,6 kg/m ²	2,2 - 2,6 kg/m ²	2,9 - 3,2 kg/m ²	2,9 - 3,2 kg/m ²	4,2 - 4,5 kg/m ²
Shënim:	Vlerat e harxhimit janë aproksimative (të përafërta) dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit.						
Dendësia e materialit kur është i thatë: (EN 1015-10):	ca. 1400 kg/m ³						
Përçueshmëria e nxehtësisë (EN 1745:2002):	ca. 0,54 W/mK						
Kapaciteti i veçantë i nxehtësisë:	ca. 1 J/kgK						
Vlera – pH:	ca. 12						
Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve(EN 1015-11):	ca. 1,0 N/mm ²						
Reagimi gjatë djegjes (EN 13501-1):	A 1						
MG (EN 998-1):	CR CS I W0						

Udhëzime të përgjithshme:

Me këtë listë të gjitha të dhënat e mëparshme për materialin bëhen të pavlefshme. Këto të dhëna janë të vlefshme për testimet tona të tanishme. Nga këto të dhëna nuk mund të dalë detyrim juridik. Prodhimet RENOVA, si dhe të gjitha lëndët e para përbërëse janë gjithmonë nën kontroll të vazhdueshëm me qëllim të ruajtjes në vazhdimësi të cilësisë së njejtë. Konsulentët tanë teknik janë gjithmonë në disponimin tuaj në lidhje me punën, përdorimin dhe prezantimin e prodhimeve tona. Gjendjen aktuale të të dhënave teknike mund ta gjeni në ueb faqen tonë: www.renova.com.mk si ose mund t'i kërkontë në sektorin e shitjes.



RENOVA PUTZ | www.renova.com.mk

RENOVA Xhepçisht, Tetovë, Maqedoni | Tel.: 044 487 300 | Fax: 044 487 200 | info@renova.com.mk
 RENOVA Gurëza, Ferizaj, Kosovë | Tel.: 00381 290 323 311 | Fax: 00381 290 396 396 | renova_ferizaj@hotmail.com
 RENOVA Vorë, Tiranë, Shqipëri | Tel.: 00355 48 301 909 | Fax: 00355 48 301 908 | renova.tirana@hotmail.com